



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.297/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Anr.297/2019 e datës 05.10.2019, me të cilin ka kërkuar që koalicionit: NISMA-AKR-PD, t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postimit te fotove në rrjetin social Facebook.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datën 05.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, koalicioni NISMA-AKR-PD, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve për ankese, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për te provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruar nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponzorimet e fushatës

zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kanë qenë jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.297 /2019 më datën 06.10.2017

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*